



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.171

13 nëntor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 008 datë 27.10.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar 8381
Ligj nr.10 009 datë 30.10.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë për lehtësimin e lëshimit të vizave” 8385
Ligj nr.10 010 datë 30.10.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë për ripanimin e personave me qëndrim të paautorizuar” 8392
Ligj nr.10 011 datë 30.10.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. 8405
Ligj nr.10 012 datë 30.10.2008	Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr.8932, datë 25.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar 8406
Vendim i Kuvendit nr.224, datë 30.10.2008	Për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor, ngritur me vendimin nr.192, datë 30.6.2008, të ndryshuar 8407
Vendim i KM nr.1445, datë 29.10.2008	Për dhënien me qira, pa konkurrim, “Top Channel” sh.a., të objektit “Ish-laboratori i filmit”, në pronësi të Albafilm sh.a., Tiranë 8407

Udhëzim i MF nr.30/1, datë 7.11.2008	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 17.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja”	8408
Udhëzim i MF dhe KKRT nr.36, datë 11.11.2008	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive	8409
Udhëzim i MASH nr.34, datë 29.9.2008	Për strukturën e vitit akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë dhe masat që duhen marrë për zbatimin e saj	8410
Udhëzim i MASH nr.35, datë 17.10.2008	Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të rishpërndara në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2008- 2009	8411
Udhëzim i MASH nr.36, datë 22.10.2008	Për procedurat e pranimi dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009	8414
Udhëzim i MASH nr.37, datë 29.10.2008	Për transferim studimesh në ciklin e parë me kohë të plotë në vitin akademik 2008-2009	8415

LIGJ
Nr.10 008, datë 27.10.2008

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9323, DATË 25.11.2004 “PËR BARNAT
DHE SHËRBIMIN FARMACEUTIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 “Përkufizime” shtohen pikat 28 dhe 29 me këtë përmbajtje:

“28.“Drejtoria e shëndetit publik rajonale” (më poshtë DSHP-ja rajonale) është autoriteti që koordinon, drejton dhe kontrollon gjithë shërbimin shëndetësor në nivel vendor, nëpërmjet strukturave farmaceutike, të cilat përbëhen nga farmacistë.

29.“Farmacist” është profesionisti i diplomuar si farmacist, me një cikël unik të paktën 5-vjeçar (Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë). Njihen, në të njëjtën masë, diplomat e lëshuara nga Universiteti i Tiranës, dega farmaci, sipas programit të mëparshëm të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe diplomat e huaja në farmaci, të ekuivalentuara nga kjo ministri.”.

Neni 2

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Procedura e përshpejtuar e regjistrimit

Barnat e regjistruara në Agjencinë Europiane të Vlerësimit të Barnave (EMA), në Administratën Amerikane për Ushqimin dhe Barnat (FDA), në Zvicër, në Kanada, në Australi, si dhe barnat e regjistruara sipas procedurave komunitare në Bashkimin Europian regjistrohen automatikisht brenda 30 ditëve pune, pas verifikimit të vërtetësisë së dokumentacionit të dorëzuar.”.

Neni 3

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Botimi i regjistrimit të barnave

1. QKKB-ja përgatit dhe boton, periodikisht, çdo vit, regjistrin e barnave me çmimet përkatëse dhe emrin e importuesve të autorizuar nga kompanitë mbajtëse të licencës së tregtimit ose nga kompanitë prodhuese dhe bën përditësimin e tij çdo muaj.

2. QKKB-ja është e detyruar të depozitojë regjistrin e barnave dhe përditësimet e tij pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. QKKB-ja është e detyruar të njoftojë menjëherë subjektet farmaceutike dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo bar të ri që regjistrohet ose çregjistrohet dhe për çdo bar të paregjistruar që importohet me autorizim të veçantë.”.

Neni 4

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20
Pulla e kontrollit

1. Të gjitha barnat e hedhura në treg kanë, detyrimisht, të vendosur pullën e kontrollit, të shpërndarë nga QKKB-ja.
2. Pulla e kontrollit duhet të jetë e dyfishtë dhe të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:
 - a) emrin dhe dozën e barit;
 - b) çmimin me pakicë të barit;
 - c) emrin e importuesit të autorizuar.
2. Elementet e tjera të pullës së kontrollit dhe procedurat për prodhim dhe stampim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24
Tregtimi me shumicë i barnave

1. Veprimtaria e tregtisë me shumicë të barnave ushtrohet nga persona juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencë vetëm nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Për fillimin e veprimtarisë së mësipërme, subjekti i interesuar deklaron, në përgjegjësinë e vet, se përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për këtë qëllim.
3. DSHP-ja rajonale bën verifikimin e deklarimeve të dhëna nga subjekti brenda 20 ditëve pune.
4. Nëse deri në përfundim të këtij afati ky autoritet nuk shprehet, drejtoria farmaceutike pranë Ministrisë së Shëndetësisë, brenda 5 ditëve pune, ia përcjell këtë procedurë Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, e cila shprehet brenda 10 ditëve pune.
5. Pas marrjes së raportit të inspektimit, të lëshuar nga DSHP-ja përgjegjëse ose QKKB-ja, Ministria e Shëndetësisë ka kohë 10 ditë pune për të dhënë licencën. Licenca tërhiqet nga subjekti pranë zyrave të DSHP-së rajonale.
6. Shpërndarësi farmaceutik duhet të ketë të punësuar një drejtues teknik farmacist.
7. Drejtuesi teknik dhe farmacistët e punësuar regjistrohen pranë DSHP-së rajonale.
8. Subjekti i licencuar për veprimtarinë e tregimit me shumicë të barnave mund të tregtojë me shumicë edhe materiale mjekimi, aksesorë, si dhe artikuj higjieno – kozmetikë dhe dietetikë.
9. Kriteret dhe procedurat e miratimit të veprimtarisë, si dhe forma e vetëdeklarimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25
Drejtuesi teknik i shpërndarësit farmaceutik

Drejtuesi teknik i importuesit, eksportuesit dhe shpërndarësit farmaceutik është farmacisti, anëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, me një përvojë pune prej 2 vjetësh në sektorin farmaceutik, i cili përgjigjet për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillon subjekti përkatës.”.

Neni 7

Në nenin 31, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:
“b) ka një përvojë pune prej dy vjetësh;”.

Neni 8

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Farmacia

1. Veprimtaria e farmacisë mund të ushtrohet nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, të licencuar nga DSHP-ja rajonale.
2. Për fillimin e veprimtarisë së mësipërme, subjekti i interesuar deklaron, në përgjegjësinë e vet, se përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për këtë qëllim.
3. Deklarimi i rremë përbën shkak për moslicencim të subjektit për një periudhë 5-vjeçare.
4. DSHP-ja rajonale bën verifikimin e deklarimeve të dhëna nga subjekti brenda 20 ditëve pune.
5. Nëse deri në përfundim të këtij afati ky autoritet nuk shprehet, veprimtaria quhet e miratuar.
6. DSHP-ja rajonale duhet të njoftojë periodikisht dhe brenda 10 ditëve pune QKKB-në për çdo farmaci të re që hapet në territorin e saj.
7. QKKB-ja bën inspektimin e veprimtarisë së re brenda 5 ditëve pune nga marrja e njoftimit.
8. Farmacia lejohet të ushtrojë veprimtari vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar.
9. Drejtuesi teknik i farmacisë është i licencuar vetëm për një farmaci.
10. Drejtuesi teknik dhe farmacistët e punësuar në farmaci duhet të regjistrohen pranë DSHP-së rajonale.
11. Kriteret dhe procedurat e miratimit të veprimtarisë, si dhe forma e vetëdeklarimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 9

Nenet 33 dhe 34 shfuqizohen.

Neni 10

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Agjencia farmaceutike

1. Në zonat rurale, ku nuk ka farmaci, miratohet hapja e agjencive farmaceutike me drejtues teknik ndihmësfarmacist, mbi bazën e vetëdeklarimit të tij për plotësimin e kriterëve të kërkuara.
2. Për fillimin e veprimtarisë së shitjes së barnave në agjenci farmaceutike, ndiqet procedura e parashikuar në nenin 32 të këtij ligji.
3. Agjencia farmaceutike tregon barna me pakicë, në bazë të listës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.”.

Neni 11

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 46

Veprimtaria e import – eksportit të barnave

1. Veprimtaria e import-eksportit të barnave ushtrohet nga persona juridikë, vendas ose të huaj, vetëm pas marrjes së licencës profesionale për drejtuesin teknik farmacist me përvojë pune 2-vjeçare në profesion.

2. Për t'u pajisur me licencë, subjekti ndjek procedurat e parashikuara në nenin 24 të këtij ligji.”.

Neni 12

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 47

Importi i barnave të regjistruara

1. Barnat e regjistruara në Republikën e Shqipërisë importohen nga importuesit e autorizuar nga kompanitë mbajtëse të licencës së tregtimit ose nga kompanitë prodhuese, në bazë të regjistrit të botuar të barnave, sipas nenit 18 të këtij ligji.

2. Procedura e importit bëhet pranë zyrave doganore të hyrjes, në prani të inspektorit farmaceutik.”.

Neni 13

Neni 58 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 58

Pezullimi i veprimtarive të miratuara, heqja e licencës dhe bllokimi e konfiskimi i barnave

1. Kur inspektorët farmaceutikë vërejnë kundërvajtje administrative, në përputhje me nenin 57 të këtij ligji, i propozojnë DSHP-së përgjegjëse dhe njoftojnë Ministrinë e Shëndetësisë për:

a) pezullimin e veprimtarisë;

b) heqjen e licencës.

2. Inspektorët farmaceutikë bëjnë bllokimin dhe konfiskimin e barnave në rastet e shkeljeve, që përcaktohen në këtë ligj.”.

Neni 14

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 59

Administrimi dhe asgjësimi i barnave të konfiskuara

1. Barnat e konfiskuara, që janë të përdorshme, me dokumentacion të rregullt, kalojnë në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Barnat e bllokuara dhe të konfiskuara, të cilat janë të papërdorshme, asgjësohen në prani të inspektorëve farmaceutikë, me procesverbal të rregullt, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, me shpenzimet e subjektit që ka bërë shkeljen.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5927, datë 11.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 009, datë 30.10.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR LEHTËSIMIN E LËSHIMIT TË VIZAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë për lehtësimin e lëshimit të vizave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5928, datë 11.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR LEHTËSIMIN E LËSHIMIT TË VIZAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, që këtu quhen palët,

me dëshirën, që si hap i parë konkret drejt regjimit të udhëtimit pa viza, për të lehtësuar kontaktet ndërmjet njerëzve si një kusht i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të lidhjeve ekonomike, humanitare, kulturore, shkencore dhe të tjera, duke lehtësuar lëshimin e vizave për qytetarët e Republikës së Shqipërisë;

duke pasur parasysh se qytetarët norvegjezë janë të përjashtuar nga kërkesa për vizë për të udhëtuar në Republikën e Shqipërisë për një periudhë kohore që nuk tejkalon 90 ditë për një periudhë prej 180 ditësh ose kalimin transit në territorin e Republikës së Shqipërisë;

duke njohur që, nëse Republika e Shqipërisë do të rivendoste kërkesën për vizë për shtetasit e Mbretërisë së Norvegjisë, të njëjtat lehtësira që jepen në bazë të kësaj Marrëveshjeje për shtetasit e Republikës së Shqipërisë do të zbatoheshin automatikisht edhe për shtetasit norvegjezë;

duke njohur që lehtësimi i vizave nuk duhet të shkaktojë migrim të paligjshëm dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurisë dhe ripranimit;

duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë për ripranimin e personave pa autorizim, kanë rënë dakord sa më poshtë.

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është lehtësimi i lëshimit të vizave për një qëndrim që synohet jo më shumë se 90 ditë për një periudhë prej 180 ditësh për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

2. Nëse Republika e Shqipërisë do të rivendoste kërkesën për vizë për shtetasit norvegjezë ose

kategori të tjera të qytetarëve norvegjezë, të njëjtat lehtësira që u jepen në bazë të kësaj Marrëveshjeje qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, do të zbatoheshin automatikisht në bazë të reciprocitetit për shtetasit norvegjezë.

Neni 2

Dispozitë e përgjithshme

1. Lehtësirat e vizave të parashikuara në këtë Marrëveshje zbatohen për shtetasit e Republikës së Shqipërisë në masën që ata nuk janë të përjashtuar nga kërkesa për vizë në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore të Mbretërisë së Norvegjisë, kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare.

2. Ligji i brendshëm i Republikës së Shqipërisë ose ligji i brendshëm i Mbretërisë së Norvegjisë zbatohet për çështjet që nuk janë të mbuluara nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, si refuzimi i një vize, njohja e dokumenteve të udhëtimit, provimi i mjeteve të mjaftueshme të jetesës dhe refuzimi i hyrjes dhe masat e dëbimit.

Neni 3

Përkufizim

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- a) “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” është një person që ka shtetësinë shqiptare.
- b) “Shtetas i Mbretërisë së Norvegjisë” është një person që ka shtetësinë norvegjeze.
- c) “Viza” është autorizimi i lëshuar ose një vendim i marrë nga Mbretëria e Norvegjisë, i tillë që kërkohet me qëllim të:
 - hyrjes për një qëndrim të synuar në Mbretërinë e Norvegjisë ose në disa shtete anëtare të Shengenit për jo më shumë se 90 ditë në tërësi;
 - hyrjes për kalim transit në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë ose disa shteteve anëtare të Shengenit.
- d) “Person me banim të ligjshëm” do të thotë një shtetas i Republikës së Shqipërisë i autorizuar ose me të drejtë qëndrimi për më shumë se 90 ditë në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë në bazë të legjislacionit të brendshëm.
- e) “Shtet anëtar i Shengenit” do të thotë çdo shtet që aplikon plotësisht rregullat e Shengenit.

Neni 4

Provat shkresore në lidhje me qëllimin e udhëtimit

1. Për kategoritë e mëposhtme të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, dokumentet e mëposhtme janë të mjaftueshme për të provuar qëllimin e udhëtimit në Mbretërinë e Norvegjisë:

a) për anëtarët e delegacioneve zyrtare që, në bazë të një ftese zyrtare drejtuar Republikës së Shqipërisë, marrin pjesë në takime, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në aktivitetet e organizuara në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë nga organizatat ndërqeveritare:

- një shkresë lëshuar nga autoriteti shqiptar që konfirmon se kërkuesi është anëtar i delegacionit shqiptar që udhëton për në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë për të marrë pjesë në ngjarjet e sipërpërmendura, të shoqëruar me një kopje të ftesës zyrtare;

b) për biznesmenët dhe përfaqësuesit e organizatave të biznesit:

- një kërkesë me shkrim nga një person juridik ose një shoqëri, organizatë pritëse, ose një zyrë apo degë e këtij personi juridik apo shoqërie, shteti ose autoritetet lokale të Mbretërisë së Norvegjisë ose komiteteve organizuese të ekspozitave tregtare dhe industriale, konferencave dhe simpoziumeve të mbajtura në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë, të miratuara nga një dhomë tregtie e Republikës së Shqipërisë;

c) për gazetarët:

- një certifikatë ose dokument tjetër të lëshuar nga një organizatë profesionale që provon se personi i interesuar është një gazetar i kualifikuar dhe një dokument i lëshuar nga punëdhënësi i tij/saj që deklaron se qëllimi i udhëtimit është ushtrimi i aktivitetit të gazetarisë;

d) për personat që marrin pjesë në aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë universitetin dhe programe të tjera shkëmbimi:

- një kërkesë me shkrim nga organizata pritëse për të marrë pjesë në këto aktivitete;

e) për përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile gjatë ndërmarrjes së udhëtimeve për qëllimet

e trajnimit edukativ, seminareve, konferencave, duke përfshirë brenda kuadrit të programeve të shkëmbimit:

- një kërkesë me shkrim lëshuar nga organizata pritëse, një konfirmim që personi përfaqëson organizatën e shoqërisë civile dhe vërtetimin për themelimin e kësaj organizate nga regjistri përkatës i lëshuar nga autoriteti shtetëror në pajtim me legjislacionin e brendshëm;

- f) për nxënësit, studentët, studentët pasuniversitarë dhe mësuesit shoqërues që ndërmarrin udhëtime për qëllimin e studimit ose trajnimit arsimor, duke përfshirë në kuadrin e programeve të shkëmbimit, si dhe aktivitete të tjera në lidhje me shkollën:

- një kërkesë me shkrim ose një vërtetim regjistrimi nga universiteti, akademia, instituti, kolegji ose shkolla pritëse, ose librezë e studentit ose vërtetimi i lëndëve që do të ndiqen;

- g) për pjesëmarrësit në aktivitetet sportive ndërkombëtare dhe personat shoqërues të tyre në cilësinë profesionale:

- një kërkesë me shkrim nga organizata pritëse: autoritetet kompetente, federatat kombëtare sportive ose Komiteti Kombëtar Olimpik i Mbretërisë së Norvegjisë;

- h) për pjesëmarrësit në programet zyrtare të shkëmbimit të organizuar nga qytetet e binjakëzuara:

- një kërkesë me shkrim të kreut të administratës/kryetarit të bashkisë të këtyre qyteteve;

- i) për të afërmit e afërt — bashkëshort, fëmijë (duke përfshirë të adoptuarit), prindërit (duke përfshirë kujdestarët), prindërit e prindërve dhe fëmijët e fëmijëve— që vizitojnë qytetarët shqiptarë me banim të ligjshëm në territorin e Norvegjisë:

- kërkesë me shkrim nga personi pritës;

- j) për arsye të vizitave për varrimet civile dhe ushtarake:

- një dokument zyrtar që konfirmon ekzistencën dhe ruajtjen e varrit, si dhe marrëdhëniet familjare ose të tjera ndërmjet kërkuesit dhe të varrosurit;

- k) për personat e përndjekur për motive politike gjatë regjimit komunist në Republikën e Shqipërisë:

- një vërtetim i lëshuar nga Instituti për Integrimin e Personave të Persekutuar në pajtim me nenin 3 të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, që tregon statusin e qenies së një personi të përndjekur për motive politike gjatë regjimit komunist në Republikën e Shqipërisë dhe një ftesë nga një autoritet kompetent, organizatë kombëtare ose ndërkombëtare duke përfshirë një OJQ të Mbretërisë së Norvegjisë ose nga një institucion europian për pjesëmarrje në aktivitete, sipas rastit, duke përfshirë aktivitetet në lidhje me statusin tyre;

- l) për shoferët që kryejnë shërbime transporti ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë në automjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë:

- një kërkesë me shkrim nga shoqata (bashkime) kombëtare e transportuesve të Republikës së Shqipërisë, që parashikon transport ndërkombëtar rrugor, që cakton qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve;

- m) për personat që udhëtojnë për turizëm:

- një vërtetim ose faturë nga një agjenci udhëtimi ose operator i turit të akredituar nga Mbretëria e Norvegjisë ka dhe anëtarë të tjerë të Shengenit në kuadrin e një bashkëpunimi konsullor lokal që konfirmon rezervimin e një udhëtimi të organizuar;

- n) për personat që bëjnë vizita për qëllime mjekësore dhe personat e nevojshëm shoqërues:

- një dokument zyrtar të institucionit mjekësor që konfirmon domosdoshmërinë e kujdesit mjekësor në këtë institucion, domosdoshmërinë e të qenit të shoqëruar dhe prova për mjete të mjaftueshme financiare për të paguar për trajtimin mjekësor;

- o) për anëtarët e profesioneve që marrin pjesë në ekspozita ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, seminare ose ngjarje të tjera të ngjashme të mbajtura në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë:

- një kërkesë me shkrim nga organizata pritëse që konfirmon se personi i interesuar do të marrë pjesë në aktivitet;

- p) për anëtarët e ekuipazhit të trenave, frigoriferëve dhe lokomotivave në trenat ndërkombëtarë, që udhëtojnë në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë:

- një kërkesë me shkrim nga shoqëria kompetente e hekurudhave të Republikës së Shqipërisë që tregon qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve;

- q) për personat që bëjnë vizita për ceremonitë e varrimeve:

- një dokument zyrtar që konfirmon faktin e vdekjes, si dhe konfirmimin e marrëdhënies familjare ose tjetër ndërmjet kërkuesit dhe të varrosurit;

- r) për përfaqësuesit e komuniteteve fetare:

- një kërkesë me shkrim nga një komunitet fetar i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që tregon

qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve.

2. Kërkesa me shkrim e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban elementet e mëposhtme:

s) për personin e ftuar — emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, seksin, shtetësinë, numrin e dokumentit të identifikimit, kohën dhe qëllimin e vizitës, numrin e hyrjeve dhe, sipas rastit, emrin e bashkëshortit dhe të fëmijëve që shoqërojnë personin e ftuar;

t) për personin që bën ftesën — emrin, mbiemrin dhe adresën; ose

u) për personin juridik, shoqërinë ose organizatën që bën ftesën — emrin dhe adresën e plotë; dhe

- nëse kërkesa është lëshuar nga një organizatë, emrin dhe pozicionin e personit që ka nënshkruar kërkesën;

- nëse personi që bën ftesën është person juridik ose shoqëri, apo një zyrë ose degë e një personi juridik apo shoqërie të tillë të themeluar në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë, numri i regjistrimit sipas kërkesave të ligjit të brendshëm të Mbretërisë së Norvegjisë.

3. Për kategoritë e personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha kategoritë e vizave lëshohen në pajtim me procedurën e thjeshtuar pa kërkuar ndonjë provë, ftesë ose vërtetim tjetër në lidhje me qëllimin e udhëtimit, të parashikuar nga legjislacioni i Mbretërisë së Norvegjisë.

Neni 5

Lëshimi i vizave me shumë hyrje

1. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Mbretërisë së Norvegjisë lëshojnë viza hyrjeje me një afat vlefshmërie deri në pesë vjet për kategoritë e mëposhtme të personave;

a) anëtarët e Këshillit të Ministrave, Parlamentit, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, nëse ata nuk janë përjashtuar nga kërkesa për vizë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, në ushtrim të detyrave të tyre, me një afat vlefshmërie të kufizuar brenda afatit të tyre të detyrës nëse është më pak se 5 vjet;

b) anëtarët e përhershëm të delegacioneve zyrtare që, në bazë të një ftese zyrtare drejtuar Republikës së Shqipërisë, marrin pjesë rregullisht në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në aktivitetet e organizuara në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë nga organizatat ndër-qeveritare;

c) bashkëshortët dhe fëmijët (duke përfshirë të adoptuarit), që janë nën moshën 21 vjeç ose janë persona të varur, që vizitojnë shtetas shqiptarë me banim të ligjshëm në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë brenda afatit të vlefshmërisë të kufizuar në kohëzgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit të vendbanimit të tyre të ligjshëm.

2. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Mbretërisë së Norvegjisë lëshojnë viza me shumë hyrje brenda afatit të vlefshmërisë deri në një vit për kategoritë e mëposhtme të personave, me kusht që gjatë vitit të kaluar të kenë marrë të paktën një vizë, ta kenë përdorur atë në pajtim me ligjet për hyrjen dhe qëndrimin në shtetin e vizituar dhe ka edhe arsye të tjera për të kërkuar viza me shumë hyrje:

a) anëtarët e delegacioneve zyrtare, që, në bazë të një ftese zyrtare drejtuar Republikës së Shqipërisë, marrin pjesë rregullisht në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në aktivitetet e organizuara në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë nga organizatat ndër-qeveritare;

b) biznesmenët dhe përfaqësuesit e organizatave të biznesit, që udhëtojnë rregullisht për në Mbretërinë e Norvegjisë;

c) personat që marrin pjesë në aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë programet universitare dhe të tjera të shkëmbimit, që udhëtojnë rregullisht për në Mbretërinë e Norvegjisë;

d) pjesëmarrësit në aktivitetet ndërkombëtare të sportit dhe personat që i shoqërojnë në cilësinë zyrtare;

e) gazetarët;

f) pjesëmarrësit në programet zyrtare të shkëmbimit të organizuara nga qytetet e binjakëzuara;

g) shoferët që kryejnë shërbime në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve për në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë në automjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

h) personat që duhet të bëjnë rregullisht vizita për arsye mjekësore dhe personat e nevojshëm shoqëruar;

i) anëtarët e ekipazheve të trenave, frigoriferëve dhe lokomotivës në trenat ndërkombëtarë, që udhëtojnë për në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë;

j) studentët dhe studentët pasuniversitarë, që udhëtojnë rregullisht për qëllimet e studimit ose

trajnitimit arsimor, duke përfshirë në kuadrin e programeve të shkëmbimit;

k) përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Republikën e Shqipërisë, që udhëtojnë rregullisht për në Mbretërinë e Norvegjisë;

l) përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që udhëtojnë rregullisht për në Mbretërinë e Norvegjisë për qëllimet e trajnitimit arsimor, seminare, konferenca, duke përfshirë në kuadrin e programeve të shkëmbimit;

m) anëtarët e profesioneve që marrin pjesë në ekspozita ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, seminare ose aktivitete të tjera të ngjashme që udhëtojnë rregullisht për në Mbretërinë e Norvegjisë.

3. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Mbretërisë së Norvegjisë lëshojnë viza me shumë hyrje me një afat vlefshmërie prej minimalisht 2 vjet dhe maksimalisht 5 vjet për kategoritë e personave të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që gjatë viteve të kaluara ata të kenë përdorur vizat njëvjeçare me shumë hyrje në pajtim me ligjet për hyrjen dhe qëndrimin e shtetit të vizituar dhe shkaqet për kërkimin e vizës me shumë hyrje të jenë ende të vlefshme.

4. Periudha e plotë e qëndrimit për personat e përmendur në paragrafët 1 deri 3 të këtij neni nuk i kalojnë 90 ditë për një periudhë 180 ditë në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë dhe të ndonjë shteti tjetër anëtar i Shengenit.

Neni 6

Tarifa për përpunimin e kërkesave për viza

1. Tarifa për përpunimin e kërkesave për vizë të shtetasve të Republikës së Shqipërisë është 35 euro.

Shuma e sipërpërmendur mund të rishikohet në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 13(3).

Nëse Republika e Shqipërisë do të rivendoste kërkesën për vizë për qytetarët e Mbretërisë së Norvegjisë, tarifa e vizës që duhet të caktohet nga Republika e Shqipërisë nuk do të jetë më e lartë se 35 euro ose shuma e rënë dakord, nëse tarifa rishikohet në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 13(3).

2. Tarifat për përpunimin e kërkesës për vizë nuk paguhet për kategoritë e mëposhtme të personave:

a) të afërmit, bashkëshortët, fëmijët (duke përfshirë të adoptuarit), prindërit (duke përfshirë kujdestarët), prindërit e prindërve dhe fëmijët e fëmijëve të shtetasve shqiptarë me banim të ligjshëm në territorin e Norvegjisë;

b) anëtarët e delegacioneve zyrtare që, në bazë të një ftese drejtuar Republikës së Shqipërisë, marrin pjesë në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në aktivitetet e organizuara në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë nga organizatat ndërqeveritare;

c) anëtarët e Këshillit të Ministrave, Parlamentit, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, nëse nuk janë të përjashtuar nga kërkesat për vizë nga kjo Marrëveshje;

d) nxënësit, studentët, studentët pasuniversitarë dhe mësuesit që i shoqërojnë, që kryejnë udhëtime për qëllimet e studimit ose trajnitimit arsimor;

e) fëmijët nën 6 vjeç;

f) personat me aftësi të kufizuar dhe personat që i shoqërojnë ata, nëse është e nevojshme;

g) personat që kanë paraqitur dokumente që provojnë domosdoshmërinë e udhëtimit të tyre për qëllime humanitare, duke përfshirë marrjen urgjent të trajtimit mjekësor dhe personi që shoqëron këtë person, ose për të ndjekur një varrim të një të afërmi ose për të vizituar një të afërm shumë të sëmurë;

h) pjesëmarrësit në aktivitetet sportive ndërkombëtare dhe personat që i shoqërojnë ata në cilësinë zyrtare;

i) personat që marrin pjesë në aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë programe të tjera universitare të shkëmbimit;

j) pjesëmarrësit në programet zyrtare të shkëmbimit, të organizuara nga qytetet e binjakëzuara;

k) personat e përndjekur për motive politike gjatë regjimit komunist;

l) pensionistët;

m) përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që udhëtojnë për të marrë pjesë në takime, seminare, programe shkëmbimi ose kurse trajnimi;

n) gazetarët;

o) përfaqësuesit e komuniteteve fetare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

p) shoferët që kryejnë shërbime transporti ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve për në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë në automjete të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

q) anëtarët e ekuipazheve të trenave, frigoriferëve ose lokomotivave në trenat ndërkombëtarë, që udhëtojnë për në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë;

r) anëtarët e profesioneve që marrin pjesë në ekspozita ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, seminare ose aktivitete të tjera të ngjashme që organizohen në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë.

Neni 7

Kohëzgjatja e procedurave për përpunimin e kërkesave për vizë

1. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Mbretërisë së Norvegjisë e marrin vendimin për kërkesën për lëshimin e një vize brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës dhe dokumenteve që kërkohen për marrjen e vizës.

2. Afati kohor për marrjen e një vendimi për një kërkesë për vizë mund të zgjatet deri në 30 ditë kalendarike në raste të veçanta, kryesisht kur kërkohet shqyrtim i mëtejshëm i kërkesës.

3. Afati kohor për marrjen e vendimit për një kërkesë për vizë mund të pakësohet në 3 ditë pune ose më pak në raste urgjente.

Neni 8

Largimi në rastin e dokumenteve të humbura ose të vjedhura

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe të Mbretërisë së Norvegjisë që kanë humbur dokumentet e tyre të identifikimit ose të cilëve u janë vjedhur gjatë qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të Mbretërisë së Norvegjisë, mund të largohen nga ky territor mbi bazën e dokumenteve të vlefshme që japin të drejtën e kalimit të kufirit, të lëshuara nga misionet diplomatike ose zyrat konsullore të Republikës së Shqipërisë ose të Mbretërisë së Norvegjisë pa vizë ose ndonjë autorizim tjetër.

Neni 9

Zgjatja e vizës në rrethana të veçanta

Shtetasve të Republikës së Shqipërisë që nuk e kanë mundësinë të largohen nga territori i Mbretërisë së Norvegjisë në momentin e caktuar në vizën e tyre për shkaqe të forcës madhore, u zgjatet afati i vizës pa pagesë në pajtim me legjislacionin e zbatuar nga shteti pritës për periudhën e kërkuar për kthimin e tyre në shtetin e vendbanimit të tyre.

Neni 10

Pasaportat diplomatike

1. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, zotërues të pasaportave të vlefshme diplomatike, mund të hyjnë, largohen ose kalojnë transit në territorin e Mbretërisë së Norvegjisë pa vizë.

2. Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të qëndrojnë në territoret e Norvegjisë dhe në ndonjë nga shtetet anëtare të Shengenit për një periudhë që nuk kalon 90 ditë për një periudhë prej 180 ditësh.

Neni 11

Vlefshmëria territoriale e vizave

Në pajtim me rregullat dhe rregulloret e brendshme në lidhje me sigurinë kombëtare të Mbretërisë së Norvegjisë, shtetasit e Republikës së Shqipërisë kanë të drejtë të udhëtojnë brenda territorit të Mbretërisë së Norvegjisë njësoj si shtetasit e Mbretërisë së Norvegjisë.

Neni 12

Monitorimi i Marrëveshjes

Përfaqësuesit e palëve do të takohen sa herë është e nevojshme me kërkesë të njëres nga palët për të diskutuar mbi zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe nëse vlerësohet e nevojshme, propozojnë ndryshime për këtë Marrëveshje, veçanërisht në lidhje me ndryshimet e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së

Shqipërisë dhe Komunitetit European mbi lehtësimin e lëshimit të vizave.

Neni 13

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje ratifikohet ose miratohet nga palët në pajtim me procedurat e tyre përkatëse dhe hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën palët njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e përmendura më sipër janë përfunduar.

2. Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë kohore të pacaktuar, nëse nuk priset në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi pasi palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

4. Secila palë mund ta pezullojë tërësisht ose pjesërisht këtë Marrëveshje për shkaqe të rendit publik, mbrojtjes së sigurisë kombëtare ose mbrojtjen e shëndetit publik. Vendimi për pezullimin i njoftohet palës tjetër jo më vonë se 48 orë para hyrjes së tij në fuqi. Pala që ka pezulluar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje informon palën tjetër menjëherë sapo të mos ekzistojnë shkaqet e pezullimit.

5. Secila palë mund ta prishë këtë Marrëveshje duke i bërë palës tjetër një njoftim me shkrim. Kjo Marrëveshje pushon së qeni në fuqi 90 ditë pas datës së një njoftimi të tillë.

Bërë në Tiranë, më 12.9.2008, në dy kopje në gjuhën shqipe, norvegjeze dhe angleze duke qenë secili prej këtyre teksteve njëloj autentik. Në rast keqinterpretimi, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

SHTOJCË

DEKLARATË E MBRETËRISË SË NORVEGJISË MBI ACQUI-NË E SHENGENIT

Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, duke qenë palë në marrëveshjen e përfunduar ndërmjet Këshillit të Bashkimit European dhe Islandës dhe Norvegjisë lidhur me bashkimin e mëvonshëm në zbatimin, aplikimin dhe zhvillimin e *acqui*-së së Shengenit të 18 majit 1999, deklaroi se vizat e lëshuara nga pala norvegjeze, në përputhje me këtë Marrëveshje dypalëshe, do të lëshohen në përputhje me detyrimet e Norvegjisë që rrjedhin nga marrëveshja e 18 majit 1999.

LIGJ

Nr.10 010, datë 30.10.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë për ripranimin e personave me qëndrim të paaautorizuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5929, datë 11.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM
TË PAAUTORIZUAR**

Palët e larta kontraktuese, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në vijim i përmendur si “Shqipëria”, dhe Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, në vijim e përmendur si “Norvegjia”,

të vendosura për të forcuar bashkëpunimin e tyre, me qëllim për të luftuar imigracionin e paligjshëm në mënyrë më efektive;

duke dëshiruar të përcaktojnë, me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe mbi bazën e reciprocitetit, procedura të shpejta dhe të efektshme për identifikimin dhe kthimin e sigurt dhe të rregullt të personave të cilët nuk përmbushin, ose nuk i përmbushin më tej, kushtet për të hyrë, për të qëndruar ose për të banuar në territoret e Shqipërisë ose të Norvegjisë dhe për të lehtësuar kalimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi;

duke theksuar që kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shqipërisë dhe Norvegjisë që burojnë nga e drejta ndërkombëtare dhe, në veçanti, nga Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nga Konventa e 28 korrikut 1951 dhe Protokollit i 31 janarit 1967 për statusin e refugjatëve, dhe nga instrumentet ndërkombëtare për ekstradimin,

kanë rënë dakord për sa vijon.

Neni 1

Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

- a) “Shtetas i Shqipërisë” nënkupton çdo person që ka shtetësinë shqiptare.
- b) “Shtetas i Norvegjisë” nënkupton çdo person që ka shtetësinë norvegjeze.
- c) “Shtetas i një vendi të tretë” nënkupton çdo person që ka shtetësi të ndryshme nga ajo norvegjeze ose shqiptare.
- d) “Person pa shtetësi” nënkupton çdo person që nuk ka asnjë shtetësi.
- e) “Autorizim qëndrimi” nënkupton një leje të çdo lloji të lëshuar nga Norvegjia ose Shqipëria nga që i jep të drejtën një personi të qëndrojë në territorin e saj. Ky përkufizim nuk përfshin lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e saj në lidhje me shqyrtimin e një aplikimi për azil ose të një aplikimi për leje qëndrimi.
- f) “Vizë” nënkupton një autorizim të lëshuar apo një vendim të marrë nga Shqipëria ose Norvegjia, nga i cili kërkohet për të hyrë ose për të kaluar transit në territorin e saj. Ky përkufizim nuk përfshin vizën e transitit aeroportual.

PJESA I

DETYRIMET PËR RIPRANIM NGA SHQIPËRIA

Neni 2

Ripranimi i shtetasve të vet

1. Shqipëria do të ripranojë, me kërkesën e Norvegjisë dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të parashikuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë, ose nuk plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Norvegjisë, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata janë shtetas të Shqipërisë.

Kjo dispozitë do të zbatohet edhe për personat të cilëve u është hequr ose që kanë hequr dorë nga

shtetësia shqiptare që nga hyrja në territorin e Norvegjisë, me përjashtim kur këtyre personave u është premtuar natyralizimi (dhënia e shtetësisë) nga Norvegjia.

2. Shqipëria, sipas nevojës dhe pa vonesë, do ta pajisë personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që kërkohen për kthimin e tij/saj, të vlefshme për një periudhë të paktën gjashtëmujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, do të pranohet përdorimi i lejkalimit norvegjez lëshuar nga Shërbimi Kombëtar Policor për Imigracionin (aneksi 7).

Neni 3

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Shqipëria do të ripranojë, me kërkesën e Norvegjisë dhe pa formalitete të mëtejshme veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të cilët nuk plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Norvegjisë, me kusht që të provohet ose të pranohet, në mënyrë të vlefshme, në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata persona:

a) kanë ose, në kohën kur kanë hyrë, kishin vizë ose leje qëndrimi të lëshuar nga Shqipëria; ose
b) kanë hyrë në territorin e Norvegjisë pasi kanë qëndruar në, ose kanë kaluar transit nëpër, territorin e Shqipërisë.

2. Detyrimi për ripranim, i parashikuar në paragrafin 1 nuk do të zbatohet nëse:

a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar vetëm transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të Shqipërisë; ose

b) Norvegjia i ka lëshuar shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose leje qëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e saj, përveç rastit kur:

- ai person zotëron një vizë ose leje qëndrimi të lëshuar nga Shqipëria, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit të lëshuar nga Norvegjia është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara.

3. Shqipëria, sipas nevojës dhe pa vonesë, do ta pajisë personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që kërkohen për kthimin e tij/saj, të vlefshme për një periudhë të paktën gjashtëmujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, do të pranohet përdorimi i lejkalimit norvegjez lëshuar nga Shërbimi Kombëtar Policor për Imigracionin.

PJESA II

DETYRIMET PËR RIPRANIM NGA NORVEGJIA

Neni 4

Ripranimi i shtetasve të vet

1. Norvegjia do të ripranojë, me kërkesën e Shqipërisë dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të pranohet, në mënyrë të vlefshme, në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata janë shtetas të Norvegjisë.

Kjo dispozitë do të zbatohet edhe për personat të cilëve u është hequr ose që kanë hequr dorë nga shtetësia e Norvegjisë që nga hyrja në territorin e Shqipërisë, me përjashtim kur këtyre personave u është premtuar dhënia e shtetësisë nga Shqipëria.

2. Norvegjia, sipas nevojës dhe pa vonesë, do të pajisë personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumentin e udhëtimit që kërkohet për kthimin e tij/saj, të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së

vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Norvegjia, brenda 14 ditëve kalendarike, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Norvegjia, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i certifikatës shqiptare për qëllime të dëbimit.

Neni 5

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Norvegjia do të ripranojë, me kërkesën e Shqipërisë dhe pa formalitete të mëtejshme, veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të cilët nuk plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të pranohet, në mënyrë të vlefshme, në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata persona:

a) kanë ose, në kohën kur kanë hyrë, kanë pasur vizë ose leje qëndrimi të lëshuar nga Norvegjia; ose

b) kanë hyrë në territorin e Shqipërisë pasi kanë qëndruar në, ose kanë kaluar transit nëpër, territorin e Norvegjisë.

2. Detyrimi për ripranim në paragrafin 1 nuk do të zbatohet nëse:

a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar vetëm transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të Norvegjisë; ose

b) Shqipëria i ka dhënë shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose leje qëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e saj, përveç rastit kur:

- ai person zotëron një vizë ose leje qëndrimi të lëshuar nga Norvegjia, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Shqipëria është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara.

3. Norvegjia, sipas nevojës dhe pa vonesë, do të pajisë personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që kërkohen për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Norvegjia, brenda 14 ditëve kalendarike, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është e nevojshme, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Norvegjia, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i certifikatës shqiptare për qëllime të dëbimit.

PJESA III

PROCEDURA E RIPRANIMIT

Neni 6

Parimet

1. Sipas paragrafit 2, çdo transferim i një personi që do të ripranohet mbi bazën e njërit prej detyrimeve që përmbajnë nenet 2 deri 5, kërkon paraqitjen e një kërkesë për ripranim tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

2. Kërkesa për ripranim mund të zëvendësohet me një komunikim me shkrim pranë autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe kohe të arsyeshme përpara kthimit të personit në fjalë, me kusht që personi që do të ripranohet zotëron një dokument udhëtimi të vlefshëm dhe, aty ku është e zbatueshme, një vizë ose leje qëndrimi të vlefshme të shtetit të kërkuar.

Neni 7

Kërkesa për ripranim

1. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) të dhënat personale të personit që do të ripranohet (p.sh. emri, mbiemri, data e lindjes, dhe-aty ku është e mundur-vendi i lindjes, emri i babait, emri i nënës dhe vendbanimi i fundit);

b) përshkrim të mënyrave me anë të të cilave do të sigurohen provat e qarta për shtetësinë,

transitin, kushtet për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, si dhe hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm.

2. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

a) një deklaratë ku tregohet që personi që do të transferohet mund të ketë nevojë për ndihmë apo kujdes, me kusht që personi në fjalë të ketë shprehur pranimin e tij për këtë deklaratë;

b) çdo masë tjetër mbrojtjeje apo sigurie, e cila mund të jetë e nevojshme për rastin e veçantë të transferimit.

3. Një formular i përbashkët, që do të përdoret për kërkesat për ripranim, është bashkëngjitur si aneksi 5 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Mjetet e provës në lidhje me shtetësinë

1. Prova për shtetësinë, sipas neneve 2 (1) dhe 4 (1), mund të jepen veçanërisht nëpërmjet çdonjërit prej dokumenteve të renditura në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së tyre ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, Shqipëria dhe Norvegjia do të njohin reciprokisht shtetësinë pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm. Prova për shtetësinë nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

2. Provat *prima facie* (e qarta) për shtetësinë, sipas neneve 2 (1) dhe 4 (1), mund të jepen veçanërisht nëpërmjet dokumenteve të renditura në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së tyre ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, Shqipëria dhe Norvegjia do të pranojnë përcaktimin e shtetësisë, me përjashtim të rastit kur ato mund të vërtetojnë të kundërtën. Provat e qarta në lidhje me shtetësinë nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

3. Nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e renditura në aneksin 1 ose në aneksin 2, përfaqësitë kompetente diplomatike dhe konsullore të Shqipërisë ose Norvegjisë do të marrin masat, me paraqitjen e një kërkesë, për të intervistuar pa vonesë personin që do të ripranohet, me qëllim që të përcaktojnë shtetësinë e tij/saj.

Neni 9

Mjetet e provës në lidhje me shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi

1. Prova e kushteve për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, përcaktuar në nenin 3 (1) dhe nenin 5 (1), do të jepet veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës, të renditura në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje; ajo nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Çdo provë e tillë njihet reciprokisht nga Shqipëria dhe Norvegjia pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm.

2. Prova e qartë për kushtet e ripranimit të shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi, përcaktuar në nenin 3 (1) dhe 5 (1), do të jepet veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës të shënuara në aneksin 4 të kësaj Marrëveshjeje; ato nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Kur paraqiten të tilla prova *prima facie* (të qarta), Shqipëria dhe Norvegjia vlerësojnë përcaktimin e kushteve, përveç rastit kur mund të vërtetojnë të kundërtën.

3. Paligjshmëria e hyrjes, qëndrimit apo banimit do të përcaktohet me anën e dokumenteve të udhëtimit të personit në fjalë në të cilat mungojnë viza e nevojshme ose leja e qëndrimit e nevojshme në territorin e shtetit kërkuar. Një deklaratë e shtetit kërkuar që personi në fjalë është gjetur pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit, vizë apo leje qëndrimi paraqitet si provë e qartë për hyrjen, qëndrimin ose banimin e paligjshëm.

Neni 10

Afatet kohore

1. Kërkesa për ripranim duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe maksimale njëvjeçare nga koha kur autoriteti kompetent i shtetit kërkuar merr dijeni që një shtetas i një vendi të tretë apo një person pa shtetësi nuk plotëson, ose nuk i plotëson më tej, kushtet që janë në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin. Kur ka pengesa ligjore ose faktike që kërkesa të paraqitet në kohë, afati kohor, me kërkesë të shtetit kërkuar, do të shtyhet, por vetëm derisa pengesa të mos ekzistojë më.

2. Një kërkesë për ripranim duhet t'i kthehet përgjigje pa vonesë të panevojshme dhe në çdo rast

brenda një periudhe maksimale prej 14 ditësh kalendarike; për mospranimin e një kërkesë për ripranim do të jepen arsye. Afati kohor fillon nga data e marrjes së kërkesës për ripranim. Nëse brenda këtij afati kohor nuk ka përgjigje, do të konsiderohet se është rënë dakord për transferimin e personit.

3. Pasi është pranuar kërkesa, apo kur është e nevojshme, pas mbarimit të periudhës prej 14 ditësh kalendarike, personi në fjalë transferohet pa vonësë dhe, e shumta, brenda tre muajve. Mbi bazën e kërkesës së shtetit kërkues, ky afat kohor mund të zgjatet sa koha që duhet për të kaluar pengesat ligjore apo praktike.

Neni 11

Modalitetet e transferimit dhe mënyrat e transportimit

1. Para kthimit të një personi, autoritetet kompetente të Norvegjisë dhe Shqipërisë do të bien në ujdi që më parë me shkrim në lidhje me datën e transferimit, vendin e hyrjes, shoqërimin e mundshëm dhe të dhëna të tjera që kanë lidhje me transferimin.

2. Nuk do të ndalohej asnjë mjet transporti, qoftë nga ajri, toka apo deti. Kthimi në rrugë ajrore nuk do të kufizohet në përdorimin e shoqërive të transportit të Norvegjisë ose Shqipërisë dhe mund të kryhet duke përdorur avionë linje apo charter. Në rastin e kthimeve të shoqëruara, këta shoqërues nuk kufizohen vetëm në persona të autorizuar të shtetit kërkues, me kusht që të jenë persona të autorizuar nga Norvegjia ose nga Shqipëria.

Neni 12

Ripranimi i gabuar

Shqipëria do të marrë mbrapsht pa vonësë çdo person të ripranuar nga Norvegjia dhe Norvegjia do të marrë mbrapsht pa vonësë çdo person të ripranuar nga Shqipëria, nëse vërtetohet, brenda një periudhe tremujore pas transferimit të personit në fjalë, që nuk ishin plotësuar kërkesat e vendosura në nenet 2 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje. Në këto raste, autoritetet kompetente të Norvegjisë dhe Shqipërisë do të shkëmbejnë gjithashtu të gjithë informacionin e disponueshëm që ka të bëjë me identitetin aktual, shtetësinë ose itinerarin e transitit të personit që do të merret mbrapsht.

PJESA IV

OPERACIONET TRANSIT

Neni 13

Parimet

1. Norvegjia dhe Shqipëria duhet të kufizojnë transitin e shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi në raste kur këta persona nuk mund të kthehen direkt në shtetin e destinacionit.

2. Shqipëria do të lejojë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi nëse Norvegjia e kërkon një gjë të tillë dhe Norvegjia do të autorizojë transitin e shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi nëse Shqipëria e kërkon një gjë të tillë, nëse sigurohet udhëtimi i mëtejshëm transit në shtete të tjera të mundshme të transitit dhe nëse sigurohet ripranimi nga shteti i destinacionit.

3. Transiti mund të refuzohet nga Norvegjia ose Shqipëria:

a) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi rrezikon realisht të bëhet subjekt i torturës ose i trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor apo poshtërues, i dënimit me vdekje ose i përndjekjes për shkak të racës, fesë, kombësisë, pjesëmarrjes në një grup shoqëror apo një bindjeje politike të veçantë, në shtetin për ku është drejtuar apo në një shtet tjetër ku do të kalojë transit; ose

b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi do t'i nënshtrohet ndjekjes ose sanksioneve penale në shtetin e kërkuar ose në një shtet tjetër të transitit; ose

c) për arsye të shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave të tjerë të shtetit të kërkuar.

4. Norvegjia ose Shqipëria mund të anulojnë çdo leje të dhënë nëse më vonë lindin ose dalin në dritë rrethanat e përmendura në paragrafin 3, të cilat bëhen pengesë për operacionet e transitit ose nëse udhëtimi i mëtejshëm në shtete të mundshme të transitit ose ripranimi nga ana e shtetit të destinacionit nuk sigurohen më. Në këtë rast shteti kërkues e merr sërish shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi, sipas nevojës dhe pa vonësë.

Neni 14
Procedura e transitit

1. Një kërkesë për operacionet e transitit duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar me shkrim dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) llojin e transitit (me rrugë ajrore, tokësore apo detare), shtetet e tjera të mundshme për transit dhe destinacioni përfundimtar;

b) të dhënat e veçanta të personit në fjalë (p.sh.: emri, mbiemri, emri i vajzërisë, emra të tjerë që përdor ose pseudonime, data e lindjes, seksi dhe - aty ku është e mundur - vendi i lindjes, kombësia, gjuha, lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit);

c) vendi i parashikuar i hyrjes, koha e transferimit dhe përdorimi i mundshëm i shoqëruesve;

d) një deklaratë që sipas mendimit të shtetit kërkuar përmbushen kushtet sipas nenit 13 (2) dhe që nuk ka arsye për mospranim sipas nenit 13 (3).

Një formular i përbashkët për t'u përdorur për kërkesat për transit është bashkëngjitur si aneksi 6 i kësaj Marrëveshjeje.

2. Shteti i kërkuar do të njoftojë, brenda pesë ditëve kalendarike dhe me shkrim, shtetin kërkuar për pranimin, duke konfirmuar vendin e hyrjes dhe kohën e parashikuar të pranimin, ose do ta njoftojë atë për mospranimin e kërkesës dhe për arsyet e këtij mospranimi.

3. Nëse operacionet e transitit kryhen në rrugë ajrore, personi që do të ripranohet dhe shoqëruesit e mundshëm shmangen nga detyrimi për të marrë vizë transiti aeroportuale.

4. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar, pas konsultimeve reciproke, do të ndihmojnë në operacionet e transitit, në veçanti nëpërmjet mbikëqyrjes së personave në fjalë dhe dhënies së mjeteve të përshtatshme për këtë qëllim.

PJESA V
KOSTOT

Neni 15
Kostot e transportit dhe të transitit

Pa cenuar të drejtën e autoriteteve kompetente për të rimbursuar kostot, lidhur me ripranimin, të shkaktuara nga ana e personit që do të ripranohet apo nga palë të treta, të gjitha kostot e transportit në lidhje me ripranimin dhe operacionet e transitit në përputhje me këtë Marrëveshje deri në kufirin e shtetit të destinacionit përfundimtar do të përballohen nga ana e shtetit kërkuar.

PJESA VI
MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KLAUZOLA E MOSNDIKIMIT

Neni 16
Mbrojtja e të dhënave

Komunikimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm nëse është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të Norvegjisë ose Shqipërisë sipas rastit.

Përpunimi dhe trajtimi i të dhënave personale në ndonjë rast të veçantë do t'u nënshtrohet ligjeve të brendshme të Norvegjisë dhe ligjeve të brendshme të Shqipërisë. Gjithashtu do të zbatohen edhe parimet e mëposhtme:

a) Të dhënat personale duhet të transmetohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

b) Të dhënat personale duhet të mblidhen për qëllimin specifik, të qartë dhe të ligjshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe nuk duhet të përpunohen më tej qoftë nga autoriteti dërgues, qoftë nga autoriteti marrës në një mënyrë që nuk përputhet me atë qëllim.

c) Të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, përkatëse dhe të mos e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe/ose komunikuar; në veçanti, të dhënat personale që komunikohen mund të

kenë të bëjnë vetëm me sa vijon:

- të dhënat e veçanta të personit që do të transferohet (p.sh.: emri, mbiemri, emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime, seksi, gjendja civile, data dhe vendi i lindjes, kombësia aktuale dhe e mëparshme);

- pasaportën, kartën e identitetit ose dëshmia e aftësisë për drejtim mjeti (numri, periudha e vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti që e ka lëshuar, vendi ku është lëshuar);

- ndalesat dhe itineraret;

- informacione të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet ose për të shqyrtuar kërkesat e ripranimit në përputhje me këtë Marrëveshje.

d) Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, aty ku është e mundur, të përditësuara.

e) Të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave, por jo më shumë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur ose për të cilin ato përpunohen më tej.

f) Autoriteti komunikues dhe autoriteti marrës i të dhënave do të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të bërë saktësimin, eliminimin ose bllokimin e duhur të të dhënave personale në rastin kur komunikimi i tyre nuk përputhet me dispozitat e këtij neni, në mënyrë të veçantë nëse ato të dhëna nuk janë të përshtatshme, nuk janë përkatëse, janë të pasakta ose e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë komunikuar. Kjo përfshin njoftimin e çdo korrigjimi, zhdukjeje apo bllokimi nga pala tjetër.

g) Mbi bazën e kërkesës, autoriteti marrës i të dhënave do të informojë autoritetin dërgues mbi përdorimin e të dhënave të komunikuar dhe për rezultatet e përfutuara prej tyre.

h) Të dhënat personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Komunikimi i mëtejshëm për organizma të tjerë kërkon pranimin paraprak të autoritetit dërgues.

i) Autoriteti dërgues dhe autoriteti marrës i të dhënave janë të detyruar të mbajnë procesverbal me shkrim për komunikimin dhe marrjen e të dhënave personale.

Neni 17

Klauzola e mosndikimit

1. Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Norvegjisë dhe Shqipërisë që burojnë nga e drejta ndërkombëtare dhe veçanërisht nga Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Konventa e 28 korrikut 1951 dhe Protokolli i 31 janarit 1967 mbi statusin e refugjatëve, dhe instrumentet ndërkombëtare mbi ekstradimin.

2. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndalon kthimin e një personi sipas marrëveshjeve të tjera formale apo informale.

PJESA VII

REALIZIMI DHE ZBATIMI

Neni 18

Grupi i përbashkët i ekspertëve

1. Norvegjia dhe Shqipëria do t'i japin njëra-tjetrës asistencë të ndërsjellë në zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim ato do të krijojnë një grup të përbashkët ekspertësh (në vijim i quajtur “grupi i ekspertëve”) i cili do të ketë, në veçanti, detyrën:

a) të vëzhgojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

b) të propozojë ndryshime në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj, veçanërisht në dritën e ndryshimeve të ngjashme në Marrëveshjen ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, mbi ripranimin e personave dhe në anekset e asaj Marrëveshjeje.

2. Grupi i ekspertëve do të mbledhet sa herë që është e nevojshme dhe me kërkesën e Norvegjisë ose Shqipërisë.

Neni 19
Dispozitat për zbatimin

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente janë:

a) Për Shqipërinë:
Ministria e Brendshme
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 4 226932; + 355 4 279251
Faks: + 355 4 279263; + 355 4 228206
E-mail: [policiakufitare.migracioni @ mrp.gov.al](mailto:policiakufitare.migracioni@mrp.gov.al)

b) Për Norvegjinë:
Shërbimi Kombëtar Policor për Imigracionin (Politiets Utlendingsenhet) në emër të Ministrisë për
Drejtësinë dhe Policinë
Kutia postare: 9277 Gronland
N – 0134 Oslo, Norway
Tel: + 47 22 34 24 00
Faks: +47 22 34 24 80
E – mail: politiets.Utlendingsenhet@politiet.no
Drejtoria për Imigracionin (Utlendingsdirektoratet) në emër të Ministrisë së Punës dhe
Pjesëmarrjes Sociale
Kutia postare: 8108 Dep
N – 0032 Oslo, Norway
Tel: + 47 23 35 15 00
Fax: + 47 23 35 15 01
E – mail: udi@udi.no

2. Pikat e mëposhtme të kalimit kufitar do të përdoren për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) Për Shqipërinë:
- Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” – Rinas
Komisariati i Policisë – Rinas
Rinas, Tiranë, Shqipëri
Tel/Fax: + 355 4 364028
E – mail: rinas@mrp.gov.al

b) Për Norvegjinë:
- Aeroporti Gardermoen i Oslos
- Oslo (Stacioni Qendror Hekurudhor dhe Porti Qendror)
- Halden (Pika e Kalimit Svinesund)

3. Shqipëria dhe Norvegjia do të informojnë njëra-tjetrën rreth ndryshimeve që bëhen në lidhje me këto autoritete.

4. Me kërkesë të Shqipërisë ose Norvegjisë, Shqipëria dhe Norvegjia do të hartojnë protokolle zbatimi të cilat do të mbulojnë rregullat për:

- a) kushtet për kthimet e shoqëruara, përfshirë transitin e shoqëruar të shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi nën shoqërim;
- b) mjetet dhe dokumentet shtesë veç atyre të renditura në anekset 1 deri 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do të ratifikohet apo miratohet nga Shqipëria dhe Norvegjia në përputhje me procedurat e tyre përkatëse.
2. Sipas paragrafit 3, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi gjatë muajit të dytë pas datës në të cilën Shqipëria dhe Norvegjia njoftojnë njëra-tjetrën që janë përfunduar procedurat e përcaktuara në paragrafin e parë.
3. Nenet 3 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi dy vjet pas datës së përmendur në paragrafin 2.
4. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar.
5. Shqipëria dhe Norvegjia mund ta denoncojnë këtë Marrëveshje duke njoftuar zyrtarisht Palën tjetër Kontraktuese. Kjo Marrëveshje do të pushojë së vepruari gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

Neni 21

Anekset

Anekset nga 1 deri në 7 formojnë pjesët integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë, më 12.9.2008, në dy kopje në gjuhën shqipe, norvegjeze dhe angleze, duke qenë secili prej këtyre teksteve njëloj i mirëfilltë. Në rast të dallimeve, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

ANEKSI 1

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI DËSHMI E QARTË PËR SHTETËSINË

(Nenet 2 (1), 3 (1), 4 (1) dhe 5 (1))

- Pasaporta të çdo lloji (pasaporta kombëtare, pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi, pasaporta kolektive dhe pasaporta zëvendësuese, përfshirë pasaportat e fëmijëve).
- Kartat e identitetit të çdo lloji (përfshi edhe kartat e përkohshme dhe kartat provizore).
- Librezat ushtarake dhe kartat e identitetit ushtarake.
- Libreza marinarësh dhe karta shërbimi të kapitenëve të anijeve.
- Certifikata shtetësie dhe dokumente të tjera zyrtare që përmendin apo tregojnë shtetësinë.

ANEKSI 2

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI PROVË E QARTË PËR SHTETËSINË

(Nenet 2 (1), 3 (1), 4 (1) dhe 5 (1))

- Fotokopje e secilit prej dokumenteve të shënuara në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje.
- Patenta ose fotokopje të tyre.
- Certifikatat e lindjes ose fotokopjet e tyre.
- Kartat e identitetit të kompanive ose fotokopje të tyre.
- Dëshmi nga dëshmitarë.
- Dëshmi të bëra nga personi në fjalë dhe gjuha e folur prej tij/saj, përfshi edhe përfundimet e një provimi zyrtar.
- Çdo dokument tjetër që mund të ndihmojë për të përcaktuar shtetësinë e personit në fjalë.

ANEKSI 3

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, TË CILAT KONSIDEROHEN SI PROVË E KUSHTEVE PËR RIPRANIMIN E SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA

SHTETËSI
(Nenet 3 (1) dhe 5 (1))

- Vulat e hyrjes/daljes ose shënime të ngjashme në dokumentin e udhëtimit të personit në fjalë ose prova të tjera të hyrjes/daljes (p.sh. prova fotografike).
- Dokumente, certifikata dhe fatura të çdo lloji (p.sh. fatura hoteli, konfirmime për trajtim mjekësor ose spitalor, dokumente hyrjeje për në institucione publike/private, marrëveshje për marrje makinash me qira, fatura të kartave të kreditit etj., që tregojnë qartë që personi në fjalë ka qëndruar në territorin e shtetit të kërkuar.
- Bileta dhe/ose lista pasagjerësh të udhëtimeve me avion, tren, autobus apo anije, të cilat tregojnë praninë dhe itinerarin e personit në fjalë në territorin e shtetit të kërkuar.
- Informacion që tregon se personi në fjalë ka përdorur shërbimet e një agjencie transporti apo udhëtimesh.
- Dëshmi zyrtare të lëshuara, në veçanti, nga pjesëtarë të personelit të autoriteteve kufitare dhe dëshmitarë të tjerë që mund të dëshmojnë për kalimin e kufirit nga ana e personit në fjalë.
- Dëshmi zyrtare të bëra nga personi në fjalë në procedura gjyqësore apo administrative.

ANEKSI 4
LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, QË KONSIDEROHEN SI PROVA TË QARTA PËR
KUSHTET PËR RIPRANIMIN E SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA
SHTETËSI
(Nenet 3 (1) dhe 5 (1))

- Përshkrimi i vendit dhe rrethanave nën të cilat personi në fjalë është kapur pas hyrjes në territorin e shtetit kërkuar, lëshuar nga autoritetet përkatëse të atij shteti.
- Informacion lidhur me identitetin dhe/ose qëndrimin e një personi lëshuar nga një organizatë ndërkombëtare.
- Dëshmi nga personi në fjalë.
- Njoftim/konfirmim i informacionit nga pjesëtarët e familjes, shoqëruesit në udhëtim etj.

ANEKSI 5



.....
.....
.....

(Përcaktimi i autoritetit kompetent
të shtetit kërkuar)
Referenca:

(vendi dhe data)

☐ PROCEDURË E PËRSHPEJTUAR

Për

.....
.....
.....

(Përcaktimi i autoritetit kompetent
të shtetit të kërkuar)

KËRKESË PËR RIPRANIM

Sipas nenit 7 të Marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Norvegjisë për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim.

A. TË DHËNA PERSONALE

1. Emri i plotë (mbiemri i nënvizuar)

.....

Fotografia

2. Emri i vajzërisë:

.....

3. Data dhe vendi i lindjes:

.....

4. Emri i babait, emri i nënës:

.....

5. Seksi dhe përshkrimi fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenja të veçanta etj.):

.....

6. I njohur gjithashtu si (emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime):

.....

7. Shtetësia dhe gjuha:

.....

8. Gjendja civile: ☐ i martuar ☐ beqar ☐ i divorcuar ☐ i ve

Nëse është i martuar: emri i bashkëshortit/bashkëshortes.....

Emrat dhe mosha e fëmijëve (nëse ka).....

.....

.....

.....

9. Adresa e fundit në shtetin kërkues:

.....

B. RRETHANA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME TË TRANSFERUARIN

1. Gjendja shëndetësore

(p.sh.sqarime të mundshme për trajtim të veçantë mjekësor, emri latinisht i sëmundjes ngjitëse):

.....

2. Shënime treguese për person shumë të rrezikshëm:

(p.sh. i dyshuar për vepra të rënda penale; sjellje agresive):

.....

C. MJETET E PROVËS TË BASHKËNGJITURA

1.

.....

(tipi i dokumentit)

(numri seria, data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti lëshues)

(data e skadimit)

2.....

(tipi i dokumentit)

(numri seria, data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti lëshues)

(data e skadimit)

3.

(tipi i dokumentit)

(numri seria, data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti lëshues)

(data e skadimit)

4.

(tipi i dokumentit)

(numri seria, data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti lëshues)

(data e skadimit)

D. VËREJTJE/SHËNIME

.....
.....
.....
.....

0

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti që e ka lëshuar)

(data e skadencës)

2.....

(nr. i kartës së identitetit)

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti që e ka lëshuar)

(data e skadencës)

3.

(nr. i patentës)

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti që e ka lëshuar)

(data e skadencës)

4.

(nr. i dokumenteve të tjera zyrtare)

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(autoriteti që e ka lëshuar)

(data e skadencës)

D. VËREJTJE/SHËNIME

.....
.....
.....
.....

(Firma e autoritetit kërkues) (vula)

LIGJ

Nr.10 011, datë 30.10.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8872, DATË 29.3.2002 “PËR ARSIMIN DHE
FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në të gjitha nenet e ligjit fjalët “arsim i detyruar” zëvendësohen me fjalët “arsim bazë”.

Neni 2

Në nenin 11, pikat 2, 3 e 4 ndryshohen si më poshtë:

“2. Arsimi profesional, publik dhe privat, fillon pas mbarimit të arsimit bazë, me kohëzgjatje 3 vjet (2+1) dhe ndahet në dy nivele:

- a) niveli i parë vazhdon dy vjet;
- b) niveli i dytë vazhdon një vit pas nivelit të parë.

Me mbarimin e nivelit të parë, krahas dëftesës së përfundimit të këtij niveli, nxënësit pajisen me certifikatë aftësimi profesional të nivelit të parë.

Në përfundim të nivelit të dytë, nxënësit marrin dëftesën e përfundimit të këtij niveli dhe certifikatën e aftësimit profesional të nivelit të dytë.

3. Arsimi i mesëm teknik, publik dhe privat, fillon:

- a) pas mbarimit të arsimit bazë dhe zgjat katër vjet;
- b) pas mbarimit të tri viteve të arsimit profesional dhe zgjat një vit.

Nxënësit, që mbarojnë shkollat teknike, publike dhe private, krahas dëftesës së pjekurisë, marrin edhe certifikatën e aftësimit profesional dhe teknik dhe u njihet mbarimi i shkollës së mesme dhe mundësia e vazhdimit të studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

4. Formimi profesional, publik dhe privat, zhvillohet përmes kurseve të formimit, të riformimit dhe të riaftësimit profesional, me kohëzgjatje deri në dy vjet.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5930, datë 11.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 012, datë 30.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8932, DATË 25.7.2002 “PËR DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar, bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Republika e Shqipërisë merr pjesë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, në Afganistan, me një kompani, së bashku me elementet mbështetëse, një togë, së bashku me elementet mbështetëse, një ekip mjekësor dhe një ekip trajnues (Operational Mentoring Liasion Team, OMLT), efektivë të Forcave të Armatosura.”.

Neni 2

Në nenin 2, pas fjalëve “të kompanisë” shtohen fjalët “togës, ekipit mjekësor dhe ekipit trajnues”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5931, datë 11.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

VENDIM

Nr.224, datë 30.10.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR KODIN ZGJEDHOR, NGRITUR ME VENDIMIN NR.192, DATË
30.6.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor, ngritur me vendimin nr.192, datë 30.6.2008, të ndryshuar, shtyhet deri më 14 nëntor 2008.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM
Nr.1445, datë 29.10.2008**

**PËR DHËNIEN ME QIRA, PA KONKURRIM, “TOP CHANNEL” SHA, TË OBJEKTIT “ISH-
LABORATORI I FILMIT”, NË PRONËSI TË ALBAFILM SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 801 e vijues, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie me qira, pa konkurrim, “Top Channel” sh.a.-së, të objektit “Ish-laboratori i filmit”, me sipërfaqe të përgjithshme 4 918 (katër mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) m², nga të cilat 1 420 (një mijë e katërqind e njëzet) m² nën objekt, në pronësi të Albafilm sh.a.-së, Tiranë, me çmim 500 (pesëqind) lekë/m², për sipërfaqen nën objekt dhe 100 lekë/m², për sipërfaqen funksionale.

2. Afati i kontratës të jetë 20 (njëzet) vjet, me kusht që të përdoret për qëllimin, për të cilin është dhënë.

3. Autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për lidhjen e kontratës së qirasë.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Albafilm sh.a., Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**UDHËZIM
Nr.30/1, datë 7.11.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.30, DATË 17.10.2008 “PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR QARKULLIMIN E AUTOMJETEVE TË HUAJA”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 27.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 5 riformulohet si më poshtë:

“5. Për rastet kur automjeti me targë të huaj, me akt noterial, kalon në pronësi të personave të tjerë, të cilët më pas do ta pajisin me targë shqiptare sipas legjislacionit në fuqi, pronari i paraqet degës së doganës në momentin e zhdoganimit të automjetit vërtetimin e hyrjes që i është dhënë personit në pikën e kontrollit të kalimit kufitar në hyrje, me qëllim që të llogaritet edhe tarifa e shërbimit të qarkullimit të automjetit për ditët e qëndrimit në Shqipëri. Drejtoritë rajonale të transportit rrugor nuk bëjnë pajisjen me targa shqiptare, si dhe regjistrimin e mjetit pa u paguar detyrimet doganore në import dhe tarifa e shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja.”.

2. Shtojca nr.1 “Masa e tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja”, bashkëlidhur udhëzimit nr.30, datë 17.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja”, zëvendësohet me shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

SHTOJCA NR.1

MASA E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR QARKULLIMIN E AUTOMJETEVE TË HUAJA

Në euro/dita

1. Për autoveturat dhe mjetet e tjera me jo më shumë se 9 vende, përfshirë edhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit1;

2. Për mjetet e destinuara për transportin e udhëtarëve mbi 9 vende, por jo më shumë se 20 vende, përfshirë edhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit.....2;

3. Për mjetet e destinuara për transportin e udhëtarëve me më shumë se 20 vende, përfshirë edhe ndenjësën e drejtuesit të mjetitreciprocitet;

4. Për mjetet e destinuara për transportin e mallravereciprocitet.

* Në rastet kur mjetet e transportit të udhëtarëve, sipas specifikimeve të pikës 2, përfshihen në listën e dërguar zyrtarisht nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, tarifa për këto mjete përcaktohet sipas reciprocitetit.

UDHËZIM
Nr.36, datë 11.11.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE
RADIOTELEVIZIVE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i KKRT-së

UDHËZOJNË:

1. Me vjeljen e kësaj tarife ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit (KKRT).
2. Llogaritjet teknike të tarifës bëhen nga KKRT-ja sipas shtojcës nr.1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
3. KKRT-ja njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kur subjektet nuk paguajnë tarifën vjetore të shërbimeve të transmetimeve radiotelevizive, kur nuk rinovojnë licencat, si dhe në rastet e identifikimit të transmetimeve të palicencuara. Të gjitha këto tarifa arkëtohen çdo 5 ditë në Buxhetin e Shtetit.
4. Për shërbimin e kryer, KKRT-ja përfiton 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe ka transferuar në Buxhetin e Shtetit.
5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

KRYETARE E KËSHILLIT KOMBËTAR
TË RADIOS DHE TELEVISIONIT
Mesila Doda

SHTOJCA NR.1

TARIFAT VJETORE PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE

Për transmetuesit ose përsëritësit televizivë analogë tokësorë, radio FM tokësore, radio AM të operatorëve privatë radio e televizivë, kombëtarë e vendorë:

1. Për çdo transmetues ose përsëritës televiziv analogjik tokësor:

a) me fuqi të rrezatuar deri në	10 W	1500 lekë në vit;
b) me fuqi të rrezatuar deri në	100 W	6000 lekë në vit;
c) me fuqi të rrezatuar deri në	1000 W	24 000 lekë në vit;
ç) me fuqi të rrezatuar deri në	10 000 W	48 000 lekë në vit;
d) me fuqi të rrezatuar mbi	10 000 W	60 000 lekë në vit.

2. Për çdo transmetues ose përsëritës radio FM tokësore:

a) me fuqi të rrezatuar deri në	10 W	300 lekë në vit;
b) me fuqi të rrezatuar deri në	100 W	1200 lekë në vit;
c) me fuqi të rrezatuar deri në	1000 W	4800 lekë në vit;
ç) me fuqi të rrezatuar deri në	10 000 W	9600 lekë në vit;
d) me fuqi të rrezatuar mbi	10 000 W	12 000 lekë në vit.

3. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e qytetit të Tiranës, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 5.

4. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi mbi 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur mbi këto pika shumëzohet me koeficientin 2.

5. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi 50 000 deri në 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 1.5.

6. Në qoftë se transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulojnë dy ose më shumë qytete të cituara në pikat 3, 4, 5, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet vetëm një herë me koeficientin më të lartë.

7. Për çdo transmetues AM 200 000 lekë në vit.

Operatorët radio dhe/ose televizivë të ritransmetimit të programeve të huaja me përsëritës të licencuar nga KKRT-ja paguajnë vetëm 20 për qind të tarifave të përcaktuara më sipër.

UDHËZIM
Nr.34, datë 29.9.2008

PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2008-2009 NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të fillojë më 13 tetor 2008 dhe të përfundojë më 30 shtator 2009.

2. Viti akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë, diploma të nivelit të dytë, dhe në programet e studimit “master i nivelit të parë” me kohë të plotë, të fillojë në datën 20 tetor 2008 e të përfundojë në datën 30 shtator 2009.

3. Viti akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të tretë “master i nivelit të dytë” me kohë të plotë, të fillojë në datën 10 nëntor 2008 e të përfundojë më datën 30 shtator 2009.

4. Viti akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe në distancë të fillojë në datën 10 nëntor 2008 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2009.

5. Brenda datës 10 nëntor 2008, institucionet publike të arsimit të lartë të njohin studentët me pjesët e statutit që përcaktojnë treguesit e programeve të studimit, rregulloren mësimore të institucionit dhe rregulloren e programit të studimit në të cilin ata janë regjistruar.

6. Raportet e kohëzgjatjes së veprimtarive të ndryshme mësimore, gjatë vitit akademik 2008-2009, të përcaktohen nga institucionet publike të arsimit të lartë, në funksion të natyrës së programit të studimit dhe të afishohen në mjedise të dukshme.

7. Periudha 24 dhjetor 2008 deri më 5 janar 2009, të jetë periudhë pushimesh për studentët.

8. Ndarja e grupeve mësimore për të gjitha vitet e studimit dhe përgatitja e regjistrave të grupeve të përfundojë deri në datën 10 tetor 2008.

9. Miratimi dhe shpërndarja e mësimdhënies së normuar vjetore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar, në programet e studimit me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, në përputhje me udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë” të përfundojë deri në datën 10 tetor 2008.

10. Miratimi i planeve kalendarike të lëndëve që zhvillohen në programet e studimit me kohë të plotë të përfundojë deri në datën 10 tetor 2008.

11. Miratimi dhe shpërndarja e mësimdhënies së normuar vjetore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar, në programet e studimit me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2008-2009, në përputhje me udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë” të përfundojë deri në datën 30 tetor 2008.

12. Miratimi i planeve kalendarike të lëndëve që zhvillohen në programet e studimit me kohë të pjesshme të përfundojë deri në datën 6 nëntor 2008.

13. Miratimi e shpallja pranë departamenteve përkatëse e strukturës së detyrimeve të çdo programi studimi në çdo formë studimi të ofruar, afatet kohore të zhvillimit të provimeve apo formave të tjera të kontrollit përfundimtar të dijeve, të kontrolleve të pjesshme të dijeve, si edhe të paraqitjes e mbrojtjes së tezës së diplomës në përputhje me udhëzimin nr.15, datë 4.4.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” të përfundojë deri në datën 6 nëntor 2008.

14. Miratimi i programimit të kohës vjetore të punës për secilin anëtar të personelit akademik, si edhe nënshkrimi i marrëveshjes vjetore ndërmjet përgjegjësit të njësisë bazë dhe anëtarit të personelit akademik të përfundojë deri në datën 25 nëntor 2008.

15. Të merren masat organizative deri në datën 25 nëntor 2008, për planifikimin dhe realizimin e praktikave (kontrata me institucione dhe ndërmarrje shtetërore apo private etj.) dhe të dërgohet në MASH, një relacion analitik rreth dinamikës së tyre, brenda datës 1.12.2008.

16. Nga institucionet publike të arsimit të lartë të merren masat për zbatimin e udhëzimit nr.19,

datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” dhe deri më datën 25 nëntor 2008 të gjithë studentët e vitit të parë të pajisen me numrat e matrikullimit.

17. Të dhënat e regjistrave të strukturave të organizuara, sipas pikës 5 të urdhrimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.150, datë 7.4.2008 “Për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë”, të dërgohen në MASH në formë elektronike në programin EXCEL, brenda datës 15 dhjetor 2008.

18. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtoritë e konvikteve listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve.

19. Në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, brenda periudhës tetor - nëntor 2008, të informohen studentët e të gjitha cikleve të studimit rreth “Strategjisë së arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e të akteve nënligjore të bazuara në të dhe të objektivave e kërkesave të “Procesit të Bolonjës”.

20. Ngarkohen zëvendësministri për arsimin e lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi në vitin akademik 2008 -2009.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

UDHËZIM
Nr.35, datë 17.10.2008

**PËR REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË RISHPËRNDARA
NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2008- 2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimin dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009”, të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, sipas programeve përkatëse të studimit, kandidatët që shpallen fitues nga kuotat e përcaktuara pas përfundimit të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë.

2. Kandidatët të aplikojnë vetëm për vendet e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me urdhrin nr.462, datë 14.10.2008.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të “Maturës shtetërore” dhe për disa programe studimi, edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.24, datë 3.6.2008 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimin, tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008 - 2009”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A3.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët që:

a) nuk kanë mundur të përfshihen në listat e fituesve për t’u regjistruar në ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2008-2009;

b) janë përfshirë në listat e fituesve dhe nuk janë regjistruar në institucionet publike të arsimit të

lartë në vitin akademik 2008-2009;

c) janë fitues të regjistruar në një program studimi në vitin akademik 2008-2009 dhe nuk preferojnë ta ndjekin atë program studimi;

d) kanë fituar provimet me zgjedhje në vitet 2007 dhe 2008 dhe nuk figurojnë të regjistruar në programet e studimit në institucionet publike të arsimit të lartë;

e) kanë fituar konkurset e pranimit në Akademinë e Arteve dhe Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve në korrik të vitit 2008 dhe kanë fituar të dyja provimet me zgjedhje Z1 dhe Z2 në vitin 2007 ose 2008.

5. Formulari A3 përmban të gjitha kuotat e përcaktuara në listën bashkëngjitur urdhrin nr. 462, datë 14.10.2008 për secilin program studimi të ciklit të parë dhe mundëson orientimin dhe aplikimin për programin e studimit të preferuar nga kandidati, në bazë të pikëve të fituara dhe të pikëve të fituesit të fundit.

6. Formulari A3 të shpërndahet në DAR/ZA dhe në APRIAL, ku të tërhiqet nga kandidatët, të plotësohet dhe të dorëzohet i plotësuar në institucionin në të cilin është tërhequr.

7. DAR/ZA-të të tërheqin formularët A3 në APRIAL në datën 21 tetor 2008.

8. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4, germa “a”, të paraqiten në DAR/ZA në periudhën 22-26 tetor 2008 për të tërhequr formularin A3.

9. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4, gerrat “b”, “c”, “d” dhe “e”, të paraqiten në APRIAL deri në datën 22.10.2008, ora 18.00 për ta tërhequr formularin A3.

10. Dorëzimi nga kandidatët i formularëve A3 të plotësuar bëhet në DAR/ZA dhe APRIAL deri më datë 27.10.2008.

11. DAR/ZA-të sjellin në APRIAL formularët A3 të plotësuar në datën 28.10.2008.

12. APRIAL përpunon të dhënat e marra nga formularët A3 dhe në datën 5.11.2008 shpall listën përfundimtare të kandidatëve fitues të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A3, në përputhje me kuotat e rishpërndara dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dorëzon në datën 6.11.2008, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues sipas programeve përkatëse të studimit, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA. Këto institucione i afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

14. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë deri në datën 15.11.2008. Për regjistrim, kandidati të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie;

b) Certifikatë lindjeje me fotografi;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh;

e) Për kandidatët e përcaktuar në pikën 4/c, vërtetimi i çregjistrimit nga programi i mëparshëm i studimit.

15. Në rast se kandidatët fitues nuk kanë dëftesë pjekurie origjinale të kërkuar në pikën 14/a të mësipërme, të paraqesin dublikatën e dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar nga drejtoria arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse. Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë, të cilat të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Pas verifikimit të bërë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

16. Veprimet e çregjistrimit përfundimtar të kandidatëve të rinj nga sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë të dokumentohen në regjistrin bazë të studentëve nga data 7.11.2008 deri më datë 15.11.2008. Kandidatëve t’u kthehet dosja individuale me dokumentet e cilësuar në pikën 14 të këtij udhëzimi. Një kopje e listës së kandidatëve të çregjistruar të dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në APRIAL.

17. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritë e institucioneve publike të arsimit të lartë regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit”.

18. Sekretaria mësimore pajis kandidatin që bën regjistrimin sipas pikës 17 me fletëregjistrimi, ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë i

nënshkruar dhe i vulosur nga titullari i institucionit publik të arsimit të lartë/njësisë kryesore që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor.

19. Tarifa e regjistrimit prej 1500 lekësh, e arkëtuar nga kandidati për regjistrimin përfundimtar të fazës së dytë të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë në institucionin publik të arsimit të lartë, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit, ku institucioni publik i arsimit të lartë ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të institucionit tjetër publik të arsimit të lartë, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i fazës së tretë të regjistrimeve.

20. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga APRIAL me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike brenda datës 30.11.2008.

21. Institucionet publike të arsimit të lartë nga data 6.11.2008 të shpallin, në vende të dukshme në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit/çregjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

22. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

23. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Kurrikulës, APRIAL, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

UDHËZIM
Nr.36, datë 22.10.2008

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT
TË CIKLIT TË DYTË DHE MASTER I NIVELIT TË PARË, ME KOHË TË PLOTË, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit të miratuara për vitin akademik 2008- 2009”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Kandidatët fitues përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë në bazë të kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të publikuara më parë.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë. Procesi të monitorohet nga administrata e rektoratit dhe e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë.

5. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, të zhvillohet nga data 23.10.2008 deri në datën 27.10.2008, prej orës 8.⁰⁰ deri në orën 18.⁰⁰ pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore. Për regjistrim, aplikanti të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Certifikatë personale me fotografi;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2500 lekësh.

6. Pranë njësisë kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, të ngrihen komisione *ad-hoc*, për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, në përputhje me kriteret e pranimit të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

7. Komisionet *ad-hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, përcaktojnë mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara për të gjithë ata kandidatë që vijnë nga programe studimi të ngjashme, të ciklit të parë.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisë kryesore përkatëse, brenda orës 16.⁰⁰ të datës 28.10.2008, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara me vendimin nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave.

9. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 29.10.2008 deri në datën 31.10.2008, prej orës 8.⁰⁰ deri në orën 18.⁰⁰ pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës.

10. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare origjinale me regjistrimet e kryera brenda datës 30.11.2008, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

11. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 23.10.2008, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar e elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

13. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, zëvendësministri për arsimin e lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

UDHËZIM
Nr.37, datë 29.10.2008

PËR TRANSFERIM STUDIMESH NË CIKLIN E PARË ME KOHË TË PLOTË NË VITIN

AKADEMIK 2008 - 2009

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 35 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1037, datë 2.7.2008 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2008-2009”,

UDHËZOJ:

1. E drejta për të transferuar studimet apo për të ndjekur studimet në një program tjetër studimi, në ciklin e parë me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, i takon çdo individ që është:

- a) Shtetas i Republikës së Shqipërisë;
- b) Shtetas i huaj me kombësi shqiptare;
- c) Shtetas i huaj.

2. Transferimi mund të realizohet midis institucioneve të arsimit të lartë, të cilat janë krijuar sipas kuadrit ligjor “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të njohura si të tilla me vendimin nominativ të Këshillit të Ministrave, si dhe nga institucionet e huaja të arsimit të lartë drejt institucioneve publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

3. Transferimi midis programeve të të njëjtit cikël të bëhet në një nga këto mënyra:

- i) Transferim brenda të njëjtit institucion publik të arsimit të lartë;
- ii) Transferim midis institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë;
- iii) Transferimi mund të bëhet edhe nga programet e mëparshme në programet e studimit të ciklit të parë.

4. Transferimi i studimeve midis institucioneve publike të arsimit të lartë, si dhe nga institucionet private të arsimit të lartë drejt institucioneve publike të arsimit të lartë të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në statutet e institucionit dhe rregulloren e njësisë kryesore ku bëhet transferimi i studimeve, si dhe në përputhshmëri me numrin e kuotave, të cilat jepen për transferime studentësh nga Këshilli i Ministrave për çdo vit akademik, të detajuara këto në urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës për shpërndarjen e këtyre kuotave.

5. Për regjistrimin e studentëve që transferohen veprohet si vijon:

i) Njësitë kryesore të institucioneve publike pritëse të arsimit të lartë vendosin kriteret specifike, në varësi të formës së studimit dhe të programit përkatës të studimit dhe i bëjnë ato publike paraprakisht;

ii) Njësitë kryesore të institucioneve publike pritëse të arsimit të lartë ngrenë komisione *ad-hoc* të transferimeve me anëtarë të personelit akademik për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me kriteret e vendosura, si edhe njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara prej tyre në programet apo vitet e mëparshme të studimit;

iii) Transferimi kryhet si transferim i vitit akademik dhe josemestral.

iv) Institucionet dërguese të arsimit të lartë duhet të certifikojnë kundrejt institucioneve pritëse çdo dokumentacion që ka të bëjë me nivelin e studimeve të kryera nga studenti dhe rezultatet e arritura prej tij.

v) Në kuadër të veprimtarisë së orientimit dhe kujdestarisë për studentët, këshilltarë nga personeli akademik në çdo institucion të arsimit të lartë duhet të informojnë studentët për karakteristikat e përgjithshme të edukimit të kërkuar, si dhe për institucionet e ndryshme të arsimit të lartë.

vi) Për lehtësim të procesit, institucionet e arsimit të lartë të përgatisin një format aplikimi për transferim studimesh.

6. Aplikimi për transferim bëhet pranë njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, brenda afateve kohore të përcaktuara dhe të bëra publike nga institucionet e arsimit të lartë dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për transferim;
- b) Formularin tip, të hartuar dhe të publikuar nga institucionet e arsimit të lartë, të plotësuar;
- c) Përmbajtjen e programit të studimit, listën e lëndëve, të krediteve dhe të notave të fituara pranë institucionit të arsimit të lartë përkatës.

7. Studentët që transferojnë studimet midis programeve të ciklit të parë, kërkohet që të kenë marrë të paktën 30 kredite në disiplina që përfshihen në “disiplina të formimit të përgjithshëm” dhe në “disiplina të formimit karakterizues”, në programet që ata kanë studiuar.

8. Nga rregulli i parashikuar në pikën 7 bëhet përjashtim për studentët që transferohen brenda

programeve të të njëjtit cikël, nga studimi me kohë të plotë në studimin me kohë të pjesshme. Për shkak të natyrës së studimeve me kohë të plotë, studenti mund të kalojë në formën e studimit me kohë të pjesshme, pa pasur kreditet e mësipërme.

9. Studentëve që transferohen nga programet e mëparshme të studimit në një program studimi të ciklit të parë, duhet t'u vlerësohen programet e bëra dhe rezultatet e marra të jenë të barasvlershme me jo më pak se 30 kredite në programin ekzistues të institucionit publik pritës të arsimit të lartë.

10. Ngarkohet zëvendësministri i arsimit dhe i shkencës, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Fatos Beja

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.11.2008
Doli nga shtypi më 13.11.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë